

Shpallje e interesit për ofrues të shërbimeve digjitale

Informata të përgjithshme:

Iniciativa për Fuqizim Digjital (DEI) në kuadër të projektit ACCESS, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) është mekanizëm i KIESA-ës cili zbatohet nga ECIKS, që synon të ofrojë shërbime të subvencionuara dhe efikase të digjitalizimit të biznesit, për të mundësuar transformimin digjital të tyre.

Business Consultants Council si partner implementues i projektit ACCESS dhe si shoqata e vetme që përfaqëson konsulencën menaxheriale në nivel lokal, fton ekspertët/ndërmarrjet për shprehje të interesit si ofrues të shërbimeve digjitale në fushat vijuese:

- Marketingu Digjital
- Kontabiliteti Digjital dhe HR përmes platformave të licencuara
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin (CRM) dhe Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjeve (ERP)
- E-commerce (platforma të shitjes online)
- Programe të ndryshme automatizimi dhe optimizimi (kushtuar ndërmarrjeve prodhuese ose atyre që ofrojnë shërbimit)

Kriteret e përzgjedhjes për ofruesit e shërbimeve digjitale konsistojnë në:

- Të paktën 6 muaj në operim
- Nuk ka detyrime ndaj ATK-së
- Të paktën tre referenca në fushën specifike të ofrimit të shërbimit digjital
- Dëshmi e certifikimit digjital ose portofolio e shërbimeve të digjitalizimit

Aktivitetet, përgjegjësitë dhe metodologjia e punës:

- Ofruesit e kualifikuar të shërbimeve digjitale do të pranojnë Termat e Referencave nga BCC, në të cilat specifikohet shërbimet të cilat do t'ju ofrohen ndërmarrjeve përfituese.
- Ofruesit e Shërbimit Digjital dërgojnë ofertat e tyre financiare dhe afatin e zbatimit të projektit në BCC jo më vonë se 3 ditë pas marrjes së ToR. Projekti ACCESS, në emër të Ekipit Menaxhues të DEI , dërgon ofertën ndërmarrjes përfituese (aplikuese).
- Ndërmarrja përfituese duhet të zgjedhë ofruesin e shërbimit digjital jo më vonë se 3 ditë pune pas marrjes së vlerësimit dhe afatit kohor të zbatimit të projektit.

Pagesa

Ndërmarrja përfituese paguan në tërësi ofruesin e shërbimeve digjitale, përderisa KIESA nëpërmjet projekti ACCESS subvencionon në mënyrë të pjesëshme koston e shërbimeve duke filluar nga 1800-3000 Euro, varësisht nga lloji i shërbimeve.

Procesi i aplikimit:

Ofruesit e shërbimeve: Ndërmarrjet / Konsulentët individual të interesuar mund të shprehin interesin e tyre për këtë thirrje, duke dërguar certifikatën e biznesit, 3 referencat e lartcekura dhe portofolion përkatëse dëshmi të certifikimit digjital dhe vërtetimin nga ATK (që nuk posedojnë borxhe).

Shprehjen e interesit për ofrim të shërbimeve e dërgoni tek e-mail adresa: dei@bcc-ks.org jo më vonë se me datën 13.04.2020